



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:261890
Datë: 06.03.2025
Numri i dokumentit: 06945781

P.nr.834/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË P.-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtarin Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e praktikantit gjyqësor, Driton Haliti, në çështjen penale kundër të pandehurit Ibrahim Daci, për shkak të veprës penale “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve”, nga neni 366 par. 1, të KPRK-së dhe të veprës penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”, nga neni 367 par.1, të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në P.-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr. 1374/24, të dt. 19.09.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik, të dt. 19.02.2025, në prezencë të Prokurorit të shtetit Leonard Krasniqi, të pandehurit Ibrahim Daci dhe mbrojtësit të pandehurit av. Getoar Zekaj sipas autorizimit, në të njëjtën ditë mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me dt.06.03.2025, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri

IBRAHIM DACI, i biri i S., i nënës D., e gjinisë N., i lindur me, në fsh. N., K. P. ku edhe tani banon, identifikohet në bazë të Inj.nr personal,, i martuar, baba ifëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, i nacionalitetit shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

I. Pasi më parë ka siguruar e gjerë me dt. rreth orës 22:30 në Rr. Sh.K. në fshatin N., Komuna P., i pandehuri në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm për armët të Republikën e Kosovës Nr. 05/L-022, pa autorizim ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim te paautorizuar

armën e cila me ligj kategorizohet si armë zjarri të ndaluara dhe atë Një (1) pushkë 20-she nr. Serik 9031176 kal. 7.62 mm, Një karikator për pushkën e njëjtë dhe 1 (Një) pistoletë të markës C..... nr. serik T një karikator për armën e njëjtë në atë mënyrë qe pasi i pandehuri me armën e lartëcekur kishte shtirë disa herë në ahengun familjar martesën e djalit, dhe pasi policia përmes rrugëve operative ishte njoftuar për të shtëna me armë në fshatin N. Komuna P.s pasi kishte identifikuar të pandehurin i njëjti gjatë bisedës me zyrtarët policor pranon se në shtëpi posedon armët si më lart, të cilat pasi e dorëzon të njëjtat se bashku me karikatorët janë konfiskuar nga ana e policisë

-me çka ka kryer veprë penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366 par.1, të KPRK-së.

II. Pasi më parë ka siguruar e gjerë me dt. rreth orës 22:30 në Rr. Sh. K. në fshatin Nabergjan, Komuna P., i pandehuri në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm për armët të Republikën e Kosovës Nr. 05/L-022, me dashje përdor armën pistoletë pushkë 20-she nr. serik dhe pistoletën e markës C. nr. serik në ahengun familjar martesën e djalit të tij, dhe pasi policia kishte identifikuar të pandehurin i njëjti gjatë bisedës me zyrtarët policor pranon se në shtëpi posedon armët si më lart, të cilat pasi i dorëzon të njëjtat së bashku me karikatorët janë konfiskuar nga ana e policisë

-me çka ka kryer veprë penale “ Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”, nga neni 367 par.1, të KPRK-së.

Andaj, Gjykata konform nenit 7, 38, 39, 43, 46 par. 1 pika 1.1, 47, 48, 49, 69, 70, nenit 366 par.1, dhe 367 par. 1, të KPRK-së, dhe nenit 364 të KPP-së të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË dhe DËNIM ME KUSHT

Për veprën penale nga dispozitivi i I- rë, i këtij aktgjykimi i shqipton,

Dënimi me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind) euro, e të cilin dënim i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 90 (nëntëdhjetë) ditë, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, dhe

Për veprën penale nga dispozitivi i II-të, i këtij aktgjykimi i shqipton,

II. **Dënim me burgim** në kohëzgjatje prej **1 (një) viti**, të cilin dënim i pandehuri nuk do ta mbajë nëse në afat prej **1 (një) viti**, nuk do të kryejë veprë tjetër penale.

Nëse i pandehuri dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimi me gjobë Gjykata do ta zëvendësojë me dënim burgu, duke llogaritur një ditë burgim, për çdo 20 euro të gjobës.

I pandehuri obligohet në paguarjen e paushallit gjyqësor shumë prej 30 (tridhjetë) euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 20 (njëzet) euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të pandehurit i konfiskohet, arma Një (1) pushkë 20-she nr. serik dhe një karikator për pushkën e njëjtë dhe Një (1) pistoletë e markës C. nr. serik dhe një karikator për armën e njëjtë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në P. – Departamenti për Krime të Përgjithshme, ka ngritur aktakuzë, PP/II.nr. 1374/24, të dt. 19.09.2024, kundër të pandehurit Ibrahim Daci, për veprën penale “ mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve”, nga neni 366 par. 1, të KPRK-së dhe veprës penale “ Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”, nga neni 367 par.1, të KPRK-së.

Konform nenit 240 të KPP-së, me dt. 19.02.2025, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar publik, ku ishin prezent Prokurori i Shtetit Leonard Krasniqi, i pandehuri Ibrahim Daci dhe mbrojtësi i të pandehurit Av. Getoar Zekaj sipas autorizimit.

Gjykata konform dispozitave të nenit 241 par. 1, të KPP-së, e ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast i pandehuri deklaroi se i ka kuptuar këto të drejta dhe se për mbrojtës e ka shfrytëzuar këtë të drejtë, e ka angazhuar Av. Getoar Zekaj sipas autorizimit.

Pas leximit të aktakuzës, nga Prokurori i Shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues, pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i është dhënë mundësia të pandehurit që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

I pandehuri Ibrahim Daci ka deklaruar se e pranon fajësinë për dy veprat penale të cilat i vihen në barrë, ndihet i penduar, dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsëris vepra tjera penale, dhe ka shtuar se atë natë ka qit për arsye se e ka fejuar djalin.

Prokurori i shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, i njëjti është bërë në mënyrë vullnetare, ka mbështetje në shkresat e lëndës, qëndron pranë aktakuzës dhe cilësimit juridik të veprave penale, sa i përket rrethanave lidhur me dënimin i ka propozuar Gjykatës që si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit në të gjitha fazat e procedurës, ndërsa rrethanat rënduese ia lë në vlerësim Gjykatës.

Mbrojtësi i të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e te mbrojturit të tij, këtë e ka bërë në mënyrë vullnetare pa presion dhe në konsultim me atë si avokat mbrojtës, i ka propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të merr parasysh rrethanat lehtësuese

si në vijim, pranimin e fajësisë në të gjitha fazat e procedurës, keqardhjen e shprehur, sjelljen e tij pas kryerjes së veprave penale, faktin që është hera e parë që bie ndesh me ligjin dhe premtimin që nuk do të përsëris vepra tjera penale, andaj duke iu referuar të lartcekurave ka kërkuar nga gjykata që me rastin e shqiptimit të dënimit të njëjtit ti shqiptojë dënim me kusht sepse edhe përmes këtij dënimi vlerësojn se do të arrihet qëllimi siç parashihet me nenin 38 të KPRK-së.

Gjyqtari i vetëm gjykues, është i bindur, se pranimin i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 241 dhe 242 par 1 të KPP-së, pasi që i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: Raporti i oficerit .B.N #.....i dhënë në stacionin policor në P. me dt.22.07.2024, Raporti informues i hetuesit Bujar Beka #10783 me dt. 22.07.2024, Deklarata e të pandehurit Ibrahim Daci e dhënë në stacionin policor ne P. me dt. 21.07.2024, Lista e armëve të konfiskuara me nr. me datë 21.07.2024, Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes me nr..... me datë 21.07.2024, Fotoalbumi i vendit të ngjarjes 21.07.2024, Procesverbal i marrjes në pyetje në Prokurori me date 12.09.2024, Fotoalbum si dhe shkresat e lëndës, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj Gjkata konform nenit 242 par 6 të KPP-së , ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Me provat e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit Ibrahim Daci, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366 par.1 të KPRK-së, si dhe vepra penale “ Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”, nga neni 367 par.1, të KPRK-së.

Gjkata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, Gjkata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69, të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, Gjkata mori, pranimin e fajësisë, shprehjen e pendimet për veprën e kryer, premtimin se më nuk do të përsëris vepra tjera penale, faktin se i pandehuri me parë nuk ka qenë i dënuar për vepra tjera penale dhe është hera e parë që bje ndesh me ligjin, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit Gjkata nuk gjeti .

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar ne nenin 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-se, Gjykata ka përcaktuar për të pandehurit shpenzimet për paushallin gjyqësor në shumë prej 30 (tridhjetët) euro, duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri në përfundimin e saj.

Konform nenit 36 par.1, 2, 3, nënpar.3.1, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, të pandehurit i obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konform nenit 366 par 3, të KPRK-së, të pandehurit i konfiskohet, arma Një (1) pushkë 20-she nr. serik 9031176 dhe një karikator për pushkën e njëjtë dhe Një (1) pistoletë e markës Canik nr. serik T6472-16AP08678 dhe një karikator për armën e njëjtë.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPP-së, Gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE NË P.-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.834/24, e dt.06.03.2025

Praktikanti Gjyqësor
Driton Haliti

GJYQTARI
Shaqë Curri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate